

Statistikat e Mbrojtjes Sociale

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Nivelit të Jetesës, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Vera Breçani
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Nivelit të Jetesës
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	vbrecani@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	10.05.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	10.05.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	10.05.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e Mbrojtjes Sociale përmbajnë të dhëna për treguesit kryesorë të mbrojtjes sociale në Shqipëri, të cilat përfshijnë ndërhyrjet që bëjnë organet shtetërore dhe private në lehtësimin e barrës financiare të familjeve dhe individëve në nevojë, të cilëve ju lind e drejta për këto përfitime. Kjo ndërhyrje mund të jetë në formën e pagesave në para kesh, në formën e rimbursimeve të shpenzimeve të bëra nga personat e mbrojtur ose në formën e mallrave dhe shërbimeve që u ofrohen drejtpërdrejt individëve që kanë të drejtë t'i përfitojnë ato.</p> <p>Treguesit statistikorë të Mbrojtjes Sociale përmbajnë informacion për numrin e personave përfitues të pagesës së papunësisë, për familjet dhe personat përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, personat përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar, përfituesit e pensioneve urbane dhe rurale në skemën e sigurimeve shoqërore etj.</p> <p>Informacioni mblidhet nga njësitë institucionale përgjegjëse sipas përcaktimeve</p>

	ligjore, që rregullojnë ofrimin e përfitimeve sociale dhe financimin e tyre. Të dhënat janë siguruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Informacioni në fushën e mbrojtjes sociale siguron të dhëna për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpenzime buxhetore në fushën e mbrojtjes sociale; - pensionet urbane dhe rurale; - kontribuesit në sistemin e sigurimeve shoqërore; - masën e pensionit sipas llojit; - përfituesit e pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare; - familjet përfituese në skemën e ndihmës ekonomike; - kategoritë e personave në nevojë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike; - fondin e ndihmës ekonomike; - përfituesit e pagesës për aftësinë e kufizuar; - përfitues nga pagesa e papunësisë; - masën e pagesës së papunësisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Skemë e mbrojtjes sociale është një set i veçantë rregullash mbështetur nga një ose më shumë njësi institucionale që rregullojnë ofrimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe financimin e tyre.</p> <p>Pensioni i pleqërisë është një pagesë periodike në të holla, që i paguhet personave të siguruar me qëllim mbajtjen e të ardhurave nga puna edhe pas daljes në pension.</p> <p>Pensioni familjar është një pagesë mujore në të holla të cilin kanë të drejtë ta marrin personat që janë në ngarkim të personit të siguruar që vdes, i cili përfitonte më përpara pension pleqërie ose pension invaliditeti.</p> <p>Pensioni i invaliditeti është një pagesë mujore në të holla të cilin kanë të drejtë ta marrin personat e siguruar që bëhen të paaftë: a) për çdo veprimtari ekonomike; b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).</p> <p>Person me aftësi të kufizuar është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.</p> <p>Ndihma ekonomike është një pagesë periodike në para kesh që u jepet familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe disa kategorive të personave në nevojë.</p> <p>Pagesa për aftësinë e kufizuar është një përfitim në para kesh dhe në natyrë që u jepet personave me aftësi të kufizuar të cilët plotësojnë kushtet për tu cilësuar të tillë, me qëllim lehtësimin e jetesës së tyre të përditshme.</p> <p>Pagesa e papunësisë është një përfitim në para kesh, që u jepet për një periudhë deri në 12 muaj personave të cilët dalin nga tregu i punës si të papunë dhe që kanë kontribuar në sigurimin e tyre shoqëror jo më pak se 12 muaj.</p>

3.5. Njësia statistikore	Njësi statistikore janë pensionistët përfitues të pensioneve të pleqërisë, familjare dhe invaliditetit (urbane dhe rurale), familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, personat në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike, personat që përfitojnë pagesë papunësie.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet popullsisë që përfiton: <ul style="list-style-type: none"> - në skemën e sigurimeve shoqërore të pensioneve urbane dhe rurale, pensioneve të pleqërisë, pensioneve të invaliditetit, pensioneve familjare; - në skemën e pagesës së papunësisë; - në skemën e ndihmës ekonomike; - në skemën për aftësinë e kufizuar; - në qendrat e kujdesit social.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e statistikave të Mbrojtjes Sociale mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e statistikave të Mbrojtjes Sociale për skemën e pensioneve dhe të ndihmës ekonomike datojnë prej vitit 1998 dhe në vazhdim ndërsa të dhënat e statistikave të mbrojtjes sociale për skemën e papunësisë datojnë prej vitit 2000 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	<ul style="list-style-type: none"> - Numër mesatar vjetor i pensioneve urbane dhe rurale në skemën e sigurimeve shoqërore. - Numër mesatar tremujor i familjeve dhe individëve në skemën e ndihmës ekonomike. - Fondi i ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes në mijë lekë. Pagesa e papunësisë në Lekë. - Masa e pensionit mujor urban ose rural sipas llojit në Lekë.
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës për statistikën e Mbrojtjes Sociale është tremujore dhe vjetore. Ky raport i referohet të dhënave të vitit 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, statistikën e mbrojtjes sociale janë bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021 • Memorandume bashkëpunimi me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Shërbimin Social Shtetëror, Agjencinë Kombëtare për Punësim e Aftësim.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT nuk transmeton tregues në EUROSTAT në lidhje me Statistikën e Mbrojtjes Sociale.

7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>Instituti i Statistikave mbron dhe nuk shpërndan të dhëna të cilat mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të njësive statistikore. Instituti i Statistikave të Shqipërisë merr të gjitha masat e duhura parandaluese në mënyrë që të bëjë të pamundur identifikimin e njësive statistikore individuale me mjete teknike ose mjete të tjera që mund të përdoren në mënyrë të arsyeshme nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që mund të mundësojnë identifikimin e njësisë statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë nëse dhe vetëm nëse:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç përcaktohet specifikisht në Rregullore, në një mënyrë të tillë që shpërndarja e tyre të mos çënojë konfidencialitetin statistikor ose nëse</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa asnjë rezervë, për zbulimin e të dhënave.</p> <p>Të dhënat konfidenciale që i transmetohen Institutit të Statistikave përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe të vetmit persona që kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që lidhen me respektimin e konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga stafi që punon në INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë për nivelin e detajuar për të cilin të dhënat statistikore mund të shpërndahen, kështu që identifikimi, direkt ose indirekt, i njësisë statistikore të anketuar nuk është i mundur; kriteret e anonimatit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; lejen e dhënies për të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore kërkuesve shkencorë. Të dhënat e publikuara janë në nivelin e përgjithshëm, të dhënat individuale nuk publikohen.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Informacioni statistikor mbi të dhënat e Mbrojtjes Sociale publikohet në përputhje me kalendarin e aprovuar të publikimit çdo tremujor dhe publikim vjetor.
8.2. Aksesimi në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve mund të aksesohet online në faqen e internetit të INSTAT.

8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit të Statistikave të Mbrojtjes sociale janë si më poshtë :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. INSTAT Website; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Të dhënat për Mbrojtjen Sociale janë publikuar me një frekuencë tremujore dhe vjetore.
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Nuk aplikohet.
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet për mbrojtjen sociale në faqen e internetit të INSTAT të organizuara si më poshtë:</p> <p>Vjetore</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Statistikat e Mbrojtjes Sociale" • "Vjetari Statistikor Rajonal" • "Vjetari Statistikor" • "Burra dhe Gra në Shqipëri" <p>Tremujore</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Statistikat e Mbrojtjes Sociale"
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhëna më të detajuara janë të publikuara në faqen web të INSTAT: Databaza Statistikore .
10.4. Akses në të dhënat mikro	Të dhënat e mbrojtjes sociale nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro. Të dhënat e agreguara janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Niveli më i detajuar i të dhënave të agreguara që merren është në nivel qarku.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash formulari .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikave të mbrojtjes sociale gjendet në faqen e INSTAT në seksionin lidhur me Metodologjinë mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale.

10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Nivelit të Jetesës dokumenton gjithë procesin dhe procedurat e Statistikave të Mbrojtjes Sociale, për qëllimet e brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për Statistikat e Mbrojtjes Sociale është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave të Mbrojtjes Sociale ndahen në të jashtëm dhe të brendshëm. ➤ Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet e Administratës Publike; • Universitetet; • Bizneset; • Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; • Organizata kombëtare jofitimprurëse; ➤ Përdoruesit e brendshëm janë drejtoritë prodhuese të INSTAT të cilat përdorin Statistikat e Mbrojtjes Sociale si input për punën e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Klikime (Page View) në lidhje me Statistikat e Mbrojtjes sociale për vitin 2020 janë rreth 10,264 klikime. INSTAT, ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Mbrojtjes Sociale është vlerësuar me 3.62 (72.4 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë). INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve .
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për statistikave të Mbrojtjes Sociale për vitin 2020 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2016-2021). Shkalla e Plotshmërisë e Statistikave të Mbrojtjes Sociale për 2020 është 100%.

13. Saktësia dhe besueshmëria

13.1. Saktësia e përgjithshme

Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.

13.2. Gabim i kampionimit

Nuk aplikohet.

13.3. Gabim jo i kampionimit

Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.

14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore

Rezultatet e Statistikave të Mbrojtjes Sociale vjetore janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 84 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (V+84 ditë) për të dhënat e ndihmës ekonomike dhe pagesën e papunësisë, dhe 130 ditë pas periudhës së referencës për pensionet (V+130). Rezultatet e Statistikave të Mbrojtjes Sociale tremujore publikohen në faqen e internetit të INSTAT afërsisht 72 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+72). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Mbrojtjes Sociale 2020 është 31 Dhjetor 2020.

	Fusha statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore
Mbrojtja Sociale	Ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë	12/31/2020	3/25/2021	84
	Pensionet	12/31/2020	5/10/2021	130

14.2. Përpikmëria

Të dhënat mbi Mbrojtjen Sociale publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave mbi Mbrojtjen Sociale ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.

	Fusha statistikore	Periudha referuese	Data e shpallur	Data e publikimit	Vonesa në kohë
Mbrojtja Sociale	Ndihma ekonomike dhe pagesa e papunësisë	12/31/2020	3/25/2021	3/25/2021	0
	Pensionet	12/31/2020	5/10/2021	5/10/2021	0

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike

Statistikat e Mbrojtjes Sociale paraqiten në nivel vendi dhe sipas qarkut. Këto statistika janë të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.

<p>15.2. Krahasueshmëria kohore</p>	<p>Statistikat e Mbrojtjes Sociale në lidhje me treguesit e pensioneve dhe ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes datojnë që nga viti 1998 referuar databazës statistikore, duke siguruar një krahasueshmëri të gjatë kohore prej 23 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=23).</p> <p>Statistikat e Mbrojtjes Sociale në lidhje me treguesit e pagesës së papunësisë datojnë që nga viti 2000 referuar databazës statistikore. duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 21 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=21).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
<p>15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>
<p>15.4. Koherenca e brendshme</p>	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu vlerësimi i serive kohore dhe trendi i tyre.</p>
<p>16. Kostoja dhe ngarkesa</p>	<p>Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të mbrojtjes sociale pranë sektorit të Statistikave të Nivelit të Jetesës është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.</p>
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit Statistikor • Politika e Trajtimit të Gabimeve
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Informacioni mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale grumbullohet nga burimet administrative. Ofruesit kryesorë të të dhënave të statistikave të mbrojtjes sociale janë përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instituti i Sigurimeve Shoqërore; • Agjencia Kombetare për Punësim dhe Aftësim; • Shërbimi Social Shtetëror.
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Mbledhja e të dhënave është e organizuar në periudha reference tremujore dhe vjetore. Të dhënat për ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe pagesën e papunësisë mblidhen në bazë tremujore dhe vjetore, ndërsa të dhënat nga sigurimet shoqërore janë me bazë vjetore.</p>

18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Mbrojtjes Sociale për vitin 2020, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Shërbimi kombëtar i Punësimit dhe Shërbimi Social Shtetëror janë burimi kryesor i grumbullimit të të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi. Pasi mbledhen të dhënat, i nënshtrohen kontrollit të cilësisë dhe analizave statistikore dhe në rast mungesash vijohet me komunikime (email, telefon) dhe kur është e nevojshme takime me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komete	
Aneks	